
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Data 29.05.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbim printimi dhe montim sinjalistike”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP) CPV 22900000-9, 34928470-3

Fondi limit total është 2,518,035 (dy milion e pesëqind e tetëmbëdhjetë mijë e tridhjetë e pesë)

Lekë pa tvsh

“Shërbim printimi dhe montim sinjalistike”

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar. Përlllogaritja e fondit limit është referuar në nenin 76/1 (b) të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se “...Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon: b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim...”

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në shtojcën 9 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke vlerësuar që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendorsja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara..
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 55, pika 4/b në kushtet kur kjo procedurë prokurimi është procedurë e thjeshtuar të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë pajisjet e nevojshme për realizimin e objektit të kontratës, konkretisht:

- pajisje për prerje dhe përpunim të materialeve grafike dhe të sinjalistikës- 1 (një) copë
- printer UV/latex - 1 (një) copë
- pajisje dhe vegla për montim dhe instalim të sinjalistikës dhe materialeve grafike - 1 (një) copë
- mjet transporti për transportin e materialeve dhe elementeve të sinjalistikës - 1 (një) copë

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë). Dokumentacioni i paraqitur duhet të përmbajë të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e qartë të makinerive pajisjeve të kërkuara.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion pajisjet për kryerjen e shërbimit të botimit, printimit dhe të gjitha proceseve të tij.

Kërkesa për disponimin e pajisjeve minimale teknike është vendosur në funksion të natyrës dhe kompleksitetit të objektit të prokurimit, i cili përfshin prodhimin, personalizimin, printimin, transportin dhe montimin e elementeve të ndryshme të sinjalistikës dhe komunikimit vizual në ambientet e Autoritetit Kontraktor.

Objekti i kontratës përfshin realizimin e tabelave informuese, sinjalistikës së zyrave, tabelave orientuese tip totem, letrave murale me relief, elementeve me plexiglass, alumini dhe inox, si dhe produkteve të tjera të personalizuar, të cilat kërkojnë procese të ndryshme prodhimi dhe instalimi.

- Pajisje për prerje dhe përpunim të materialeve grafike dhe të sinjalistikës, të nevojshme për realizimin e elementeve prej plexiglass, forex, alumini, adezivëve dhe materialeve të tjera të përdorura në prodhimin e sinjalistikës dhe elementeve identifikuese.
- Printer UV/Latex, i nevojshëm për realizimin e printimeve cilësore mbi materiale të ndryshme, sipas specifikimeve teknike të kërkuara për tabelat informuese, sinjalistikën, logot, letrat murale dhe elementet e tjera të personalizuar objekt kontrate.
- Pajisje dhe vegla për montim dhe instalim, të nevojshme për vendosjen, fiksimin dhe instalimin e elementeve të sinjalistikës në ambientet e Autoritetit Kontraktor, duke garantuar realizimin korrekt dhe të sigurt të montimit.
- Mjet transporti, i nevojshëm për transportimin e materialeve, pajisjeve dhe produkteve të përfunduara nga ambientet e operatorit ekonomik në ambientet e Autoritetit Kontraktor, si dhe për realizimin e proceseve të montimit në vend.

2.3.3 Operatori ekonomik për realizimin e kontratës duhet të ketë minimalisht 5 (pesë) punonjës si më poshtë:

- a) 1 (një) përgjegjës shërbimi;
- b) 1 (një) specialist teknik në aplikimin e adezivit;
- c) 1 (një) punonjës grafik-dizajner;
- d) 1 (një) punonjës ndihmës;
- e) 1 (një) shofer.

Për vërtetimin e disponueshmërisë së personelit të mësipërm, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Për punonjës in në pikën a) Përgjegjës shërbimi:

- Diplomë të arsimit të lartë ose dëshmi të aftësisë profesionale sipas legjislacionit në fuqi;
- Kontratë pune të vlefshme.

Për punonjës in në pikën b) Specialist teknik në aplikimin e adezivit:

- Certifikatë profesionale, dëshmi kualifikimi ose dokument tjetër ekuivalent që vërteton njohuri dhe aftësi në aplikimin e adezivëve, montimin e sinjalistikës ose punime të ngjashme;
- Kontratë pune të vlefshme.

Për punonjës in në pikën c) Grafik-dizajner:

- Diplomë të arsimit të lartë ose dëshmi të aftësisë profesionale në fushën e grafik-dizajnit, komunikimit vizual, multimedias ose fusha të ngjashme;
- Kontratë pune të vlefshme.

Për punonjës in në pikën d) Punonjës ndihmës:

- Kontratë pune të vlefshme.

Për punonjës in në pikën e) Shofer:

- Kontratë pune të vlefshme;
- Leje drejtimi të vlefshme.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për punonjës it vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike dhe detyrave që duhet të kryejë ofertuesi, hartuar nga AK, duke siguruar ekzekutimin e shërbimit objekt prokurimi në kohë, cilësi dhe brenda afateve të kërkuara nga AK.

1. Përgjegjësi i shërbimit është i nevojshëm për koordinimin, organizimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha proceseve që lidhen me realizimin e kontratës, duke përfshirë ndjekjen e afateve të zbatimit, koordinimin me Autoritetin Kontraktor, organizimin e stafit teknik dhe kontrollin e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve që do të ofrohen.

2. Specialisti teknik është i nevojshëm për realizimin e proceseve të aplikimit të materialeve adezive, montimit të sinjalistikës, vendosjes së grafikave dhe elementeve vizuale në sipërfaqe të ndryshme. Duke qenë se kontrata përfshin sinjalistikë të brendshme dhe të jashtme, tabela orientuese, letra murale dhe elementë dekorativë, kërkohet personel me njohuri praktike dhe profesionale për të garantuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e montimit.

3. Grafik-dizajneri është i nevojshëm për përgatitjen, përshtatjen dhe finalizimin e materialeve grafike që do të prodhohen në kuadër të kontratës. Duke qenë se objekti përfshin logo me relief 3D, sinjalistikë të personalizuar, tabela informuese, letra murale, roll-up dhe materiale të tjera vizuale, nevojitet personel i kualifikuar për përgatitjen teknike të skedarëve për printim dhe prodhim.

4. Punonjësi ndihmës është i nevojshëm për mbështetjen e proceseve të prodhimit, ngarkim-shkarkimit, transportit, montimit dhe vendosjes së elementeve të sinjalistikës dhe materialeve të tjera objekt kontrate. Ky pozicion siguron asistencën e nevojshme gjatë realizimit të punimeve në terren dhe përmbushjen e detyrave operative.

5. Shoferi është i nevojshëm për transportimin e materialeve, pajisjeve dhe produkteve të përfunduara nga ambientet e operatorit ekonomik në ambientet e Autoritetit Kontraktor, si dhe për lëvizjen e stafit dhe mjeteve të nevojshme për montimin dhe instalimin e sinjalistikës në vendet e përcaktuara për realizimin e kontratës.

Kërkesa për disponimin e minimalisht 5 (pesë) punonjësve është vendosur në funksion të natyrës, kompleksitetit dhe volumit të shërbimeve që parashikohen të realizohen në kuadër të kontratës.

Objekti i prokurimit nuk konsiston vetëm në printimin e materialeve, por përfshin një sërë procesesh të ndërlidhura, si projektimi dhe përgatitja grafike e materialeve, prodhimi dhe personalizimi i elementeve të sinjalistikës, prerja dhe gdhendja me pajisje të specializuara, aplikimi i adezivëve dhe elementeve dekorative, montimi në ambientet e institucionit, si dhe transporti dhe vendosja e produkteve të përfunduara.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër të realizojë furnizimin, printimin dhe montimin e të gjithë elementeve sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor dhe brenda afatit të përcaktuar në kontratë. Të gjitha kostot e transportit, montimit, instalimit dhe vendosjes në ambientet e Autoritetit Kontraktor do të jenë në ngarkim të operatorit ekonomik.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, si dhe duke iu referuar specifikimeve teknike. Deklarata shërben për të garantuar se operatori ekonomik ka marrë në konsideratë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kontrata, përfshirë transportin, montimin, instalimin dhe vendosjen e elementeve në vendet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, pa krijuar kosto shtesë për këtë të fundit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike dhe përllogaritja e fondit limit janë përgatitur dhe hartuar nga Autoriteti Kontraktor “Ministrja e Ekonomisë dhe Inovacionit” për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit,

Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar. Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nevojat konkrete të Autoritetit Kontraktor

NJËSIA E PROKURIMIT